

Merita Saiti, MA¹
Nefail Emini, MA²

UDC: 327:662.764(262.2)

**GAZI (HIDROKARBURET) SI ELEMENT I RI GJEOPOLITIK NË
MESDHEUN LINDOR**

**ГАСОТ (ЈАГЛЕДОРОДОВИ) КАКО НОВ ГЕОПОЛИТИЧКИ
ЕЛЕМЕНТ ВО ИСТОЧНИОТ МЕДИТЕРАН**

**GAS (HYDROCARBONS) AS A NEW GEOPOLITICAL
ELEMENT IN THE EASTERN MEDITERRANEAN**

Abstract

The proximity of the Eastern Mediterranean to the Middle East, the region with the largest hydrocarbon reserves in the world, has fueled every hope that this part also has oil and gas. These hopes would materialize in 2009 when the Tamar field was discovered in Israel's territorial waters, which was the largest reserve in the region until that time. This discovery was to be followed by others even greater, not only in Israel, but also in Cyprus in 2011 in the Aphrodite field and in Egypt in 2015 in the Zohr field. This amount of gas that has been mentioned so far is much smaller compared to what has been done, where according to the US Geological Survey, the Eastern Mediterranean has a reserve of 122 trillion more cubic meters of natural gas, and about 1.7 billion barrels of oil, and these numbers may be different, but regardless, this shows the power of energy that the region has. The amount of gas has such geopolitical and geoenergetic effects, since the state is dependent on energy resources, which now not only meet their internal needs, but

¹ Merita Saiti, Bashkëpunëtoare e re në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Sektori për BE-në. Magjistruarë në Drejtimin e Diplomacisë, Universiteti i Evropës Juglindore.

² Nefail Emini, Magjistër i Diplomacisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Sekretariati për Çështje Evropiane, Sektori për IPA-t.

at the same time they turn into its exporters. Given that there are very large reserves and export power, the idea of a creation known as EstMed that would bring gas from Israel to Greece, Cyprus and with the final destination the European continent has been put forward.

Keywords: Eastern Mediterranean, Middle East, oil and gas, barrels, energy resources

Hyrje

Gjatë gjithë historisë së shoqërisë njerëzore, Mesdheu Lindor ka pasur peshë dhe rëndësi shumë të madhe politike, ekonomike dhe religjioze, pasi gjeografikisht ka lidhur tre kontinentet më të mëdha të botës, Azinë, Afrikë dhe Evropën, që e ka bërë atë të jetë e lakmueshme për t'u sunduar apo edhe dominuar jo vetëm nga fuqitë rajonale, por edhe ato globale. Rëndësia e rajonit u rrit edhe më shumë në fillimin e shekullit XX, kur në Lindjen e Mesme u zbuluan sasi të mëdha të naftës, e fal gjeografisë, kjo hapësirë shërbeu si rrugë transitore për dërgimin e hidrokarbureve drejt tregjeve të kontinentit të Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Meqenëse rajoni ishte shumë afër me Lindjen e Mesme, që është edhe rajoni me rezervat më të mëdha të naftës në botë, çdo herë ishte besuar se nëntoka e kësaj hapësire ka rezerva gjigante të hidrokarbureve, por që të njëjtat ende nuk ishin zbuluar. Fillimet e hulumtimeve për hidrokarbure kishin filluar relativisht herët, e kjo daton që nga mesi i shekullit XX. Kërkimet e para, kishin rezultuar jo shumë shpresëdhënëse, pasi rezervat e zbuluara ishin aq minimaliste, për të mos thënë të papërfillshme.

Kërkimet kishin dhënë rezultate në vitin 2000, kur Izraeli në ujërat e saj territorialë kishin zbuluar fushën Noa dhe Mary B, që kishin sasi të konsiderueshme të gazit natyror, që ishte një e arritur e jashtëzakonshme ekonomike dhe energjetike për Tel Avivin. Fushat e sapo zbuluara, rritën edhe më shumë shpresat, për gjetjen e fushave të tjera gazmbajtëse, dhe kjo përsëri dha rezultat, kur në vitin 2009 u zbulua fusha Tamar. Një vit më vonë Instituti Gjeologjik Amerikan deklaroi se në bazë të hulumtimeve, ky rajon kishte potencial prej 122 trilionë metër kub gaz natyror dhe 1.7 miliard fuçi naftë.

Në vitin 2011, do të zbulohet një rezervë e madhe e gazit, por tani në Qipro në një shtete tjetër të Mesdheut Lindor, ku fusha Afërdita

kishte një sasi shumë të madhe gazi, që kishte një ndikim të madh ekonomik energjetik dhe gjeopolitik për Nikozinë, pasi varësia e saj energjetike nga shtetet tjera ishte shumë e madhe. Në vitin 2015 do të vinte njoftimi për një zbulim tjetër shumë të madh, kur Egjipti njoftoi për gjetjen e një rezervë shumë të madhe gazi në fushën Zohr, që ishte një argument tjetër shumë i rëndësishëm se nëntoka e Mesdheut Lindor, kishte një sasi gjigante të hidrokarbureve.

Duke pasur një sasi kaq të madhe të gazit, që ishte e mjaftueshme jo vetëm për të plotësuar nevojat e brendshme, por që të njëjtat kishin edhe kapacitet për të eksportuar, u hodh ideja për krijimin e një tubacioni. EstMed do të eksportoje gazit nga Izraeli në drejtim të Qipros dhe Greqisë e më pas drejt Bashkimit Evropian, që do të kishte një efekt të jashtëzakonshëm gjeopolitik për rajonin. Për të rritur edhe më shumë bashkëpunimin mes shteteve të Mesdheut Lindor, por edhe të vendeve jashtë saj, u krijua Forumi i Gazit në Mesdheun Lindor si një organizatë ndërqeveritare për të koordinuar politikat energjetike mes vendeve.

Gazi natyror si element i ri gjeopolitik

Rajoni i Mesdheut Lindor gjatë gjithë historisë së shoqërisë njerëzore ka pasur rol dhe ndikim shumë të fuqishëm, falë pozitës si një urë lidhëse mes kontinenteve, por tani në epokën moderne, ajo posedon edhe një element shumë të rëndësishëm, që po ndikon që pesha dhe rëndësia e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare të rritet edhe më shumë pasi në këtë pjesë kemi kombinimin e dy aspekteve të fuqisë gjeopolitike që është gjeografia dhe energjia.

Duke qenë pranë Lindjes së Mesme, që është edhe rajoni më i pasur në botë sa i përket hidrokarbureve, çdo herë është besuar se nëntoka e Mesdheut Lindor ka mundësi të përmbaj këtë element aq të nevojshëm dhe kërkuar për shoqërinë moderne, e ky parashikim doli të ishte i vërtetët, pasi një koncorsium të kompanive amerikane dhe izraelite njoftuan në fillimin e vitit 2009 se ata kishin arritur që të zbulonin një sasi të madhe të gazit në rajonin e Mesdheut Lindor, që ishte një arritje shumë e madh për Izrael, por edhe për të gjithë shtetet e rajonit, pasi kjo ngjalli shpresë, se edhe në ujërat e tyre territoriale mund të zbuloheshin sasi të tilla të energjisë.

“Eksplorimi i naftës dhe gazit është kryer vazhdimisht në rajon për shumë dekada. Në Izrael, fusha të vogla gazi u zbuluan në fund të viteve 1950 në shkretëtirën jugore të Judesë. Shpimet në det të hapur në

Mesdheun lindor filluan që në vitin 1969, por për 30 vitet e ardhshme, të 17 pusët kërkimore të shpuara rezultuan të thata. Vetëm në vitet 1999-2000 u bënë zbulimet e para të mëdha në det të hapur në Ashkelon. Fusha e parë e zbuluar ishte Noa dhe më e madhja nga fushat ishte Mary B”³. Fushat e porsazbuluara do të kishin një impakt të fuqishëm për Izraelin, pasi fusha e Noa kishte një sasi rezervë prej 1.2 miliardë metër kub gaz natyror, kurse ajo e Mary B që u zbulua vetëm disa muaj më vonë përmbante një rezervë prej 25 miliardë metër kub gaz natyror. Ky zbulim pos rëndësisë ekonomike dhe energjetike, në të njëjtën kohë ajo ishte edhe një shpresë për vet Tel Avivin dhe shtete tjera të rajonit, se nëntoka e tyre mund të përmbante sasi tjera edhe shumë më të mëdha se sa këto që sapo ishin zbuluar. Në të njëjtën kohë që Izraeli po kërkonte gaz natyror, edhe Autoriteti Palestinez po bënte të njëjtën, ku në nëntor të vitit 1999 i dha një kontratë 25 vjeçare një konsorciumi i cili përbëhej nga Consolidated Contractors Limited (CCC), British Gas Group (BG) dhe Fondi i Investimeve të Palestinës (PIF) që i jepte mundësi atyre të kërkojnë për rezerva të mundshme të hidrokarbureve në ujërat e saj territorialë.

“Pas marrjes së lejes së sigurisë nga kryeministri izraelit Ehud Barak në vitin 2000, BG shpoi dy puse në Marinën e Gazës duke gjetur rezerva të vlerësuara në 1.4 trilionë këmbë kub (tfc)”⁴. Kërkimet përsëri filluan në vitin 2003, pasi ekzistonte besimi se këtu me patjetër duhet që të kishte hidrokarbure, për të cilin edhe kishin të drejtë, pasi hulumtimet dhe zbulimet e mëvonshme do të tregonin se ajo ishte një nga rajonet më të pasura në botë me gaz natyror, por edhe me naftë. Këto kërkime dhanë rezultat në vitin 2009 kur u zbulua një fushë e re gazmbajtëse 80 kilometra në perëndim të portit të Haifas brenda Zonës Ekskluzive Ekonomike të Izraelit që u njoh si fusha Tamar. Kjo fushë e sapo zbuluar mbante 281 miliardë metër kub gaz natyror dhe rreth 13 milionë fuçi naftë që ishte rezerva më e madhe që ishte zbuluar deri në atë kohë në Mesdheun Lindor. Në vitin 2013 një sasi tjetër e gazit u zbulua në Tama jugperëndimor e cila kapte një vlerë prej 26 miliard metë kub dhe 2 milionë fuçi të tjera naftë.

³ Nathanson, Roby, Levy, Ro’ee. Natural Gas in the Eastern Mediterranean Casus Belli or Chance for Regional Cooperation?, Israel 2012, <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/israel/09591.pdf>, f.8 (02.06.2022)

⁴ Victor Kattan, “The Gas Fields off Gaza: A Gift or a Curse?” Al Shabaka, the Palestinian Policy Network (April 2012), f.1 https://al-shabaka.org/wp-content/uploads/2012/04/Kattan_PolicyBrief_Eng_April_2012.pdf (07.06.2022),

“Në vitin 2010, Shërbimi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara (USGS) vlerësoi se mund të ketë deri në 1.7 miliardë fuçi naftë dhe një mesatare prej 122 trilionë këmbë kub gaz në Provincën e Pellgut Levant”⁵. Pos gazit natyror, kjo zonë përmban rreth 1.7 miliardë fuçi naftë, të cilët nëse konvertohen në vlera financiare, atëherë shkon deri në 524 miliardë dollarë për gazin, dhe rreth 100 miliardë dollarë për naftën.

Kërkimet për gaz nuk kishin ndalur në këtë zonë, ku tani pos shpresës që kishin sjellë zbulimi i fushave në kufijtë e Izraeli, por edhe konstatimi amerikan për potencialin energjetik të këtij rajoni, bëri që kërkimet të intensifikoheshin, e kjo gjë dha edhe rezultatet e pritura. Në dhjetor të vitit 2010 u zbulua fusha më e madhe e gazit e zbuluar deri më tani më Mesdheun Lindor. Fusha Levantian gjendej një jugperëndim të fushës Tamar dhe 180 kilometra larg brigjeve të Haifas, me rezerva prej 605 miliard metër kub gaz dhe 34 milionë fuçi naftë.

“Izraeli ka vlerësuar burimet e gazit prej gati 1.000 miliardë metra kub (bcm) dhe një potencial shtesë prej 400 bcm. Libani ka një potencial deri në 750 bcm. Siria ka burime të vlerësuara të 230 bcm dhe një potencial shtesë prej 170 bcm. Qiproja ka vlerësuar burime gazi prej 120 bcm dhe potencial shtesë prej gati 1.000 bcm”⁶. Të gjithë këto fusha janë të vendosura në Pellgun e Levantit e cila ka një sipërfaqe prej 83 mijë kilometra katrorë e cila shtrihet në pjesën e Mesdheut Lindor dhe përfshinë Egjiptin, Izraelin, territoret Palestineze, Sirinë, Libanin, Qipron dhe Turqinë që po u jep mundësi këtyre vendeve, që nga importues të gazit apo edhe naftës të shndërrohen në eksportues të saj, e cila do t’u sjell përfitime të mëdha ekonomike dhe politike, por njëkohësisht kjo do të shkaktojë edhe tensione sa i përket ndarjes së tyre, duke marrë parasysh kontestet e shumta kufitare, që kanë thuar se të gjitha vendet e rajonit me njëri-tjetrin.

Pos fushës Tamar dhe Levantian janë zbuluar edhe rezerva të tjera si Dalit në vitin 2009 me një sasi prej 8 miliardë metër kub, Tanin në vitin 2011 prej 35 miliardë metër kub, Karsih në vitin 2011 prej 50 miliardë metër kub, ndërsa në tetor të këtij viti u raportua së në fushën Hermes është zbuluar një rezervë që përmban nga 7 deri në 15 miliardë

⁵ C.J. Schenk, Assessment of Undiscovered Oil and Gas Resources of the Levant Basin Province, Eastern Mediterranean, U.S. Geological Survey, March 12, 2010, p. 2, <https://pubs.usgs.gov/fs/2010/3014/pdf/FS10-3014.pdf> (08.06.2022)

⁶ Zemach, Shaul. Toward an Eastern Mediterranean Integrated Gas Infrastructure?, The German Marshall Found of the United States, USA 2016, f.3, https://www.gmfus.org/sites/default/files/Zemach_EMedIntegratedGasInfrastructure_Apr16_web.pdf (09.06.2022)

kubik metër gaz. Rezervat që kanë Tamar dhe Levantian në bazë të llogaritjeve sigurojnë sasinë e nevojshme të gazit për Izraelin për një periudhë rreth 40 vite, që tregon se Tel Avivi nuk do të jetë më e varur për burime energjetike nga fqinjët e tij, por realisht nga importues do të shndërronte atë në eksportues të gazit, gjë që edhe e ka bërë. Egjipti dhe Izraeli arritën një marrëveshje 10 vjeçare në shkurt të vitit 2018, që kapte një vlerë prej 15 miliardë dollarë, për një kohëzgjatje prej 10 viteve, ku gjatë kësaj periudhe ajo do të eksportoj 64 miliardë metër kub gaz në vit, ose 5.663.000 metër kub gaz në ditë drejt Kajros.

Nga Tamara gjithashtu do të eksportohet në drejtim të Egjiptit, ku sasia e gazit për një periudhë 15 vjeçare do të jetë 25.3 miliardë metër kub, me një vlerë prej 4.5 miliardë dollarë. Gaz natyror nga kjo fushë do të eksportohet edhe në drejtim të Jordanisë, ku në bazë të një marrëveshjes së arritur në vitin 2016, Izraeli do të dërgojë në drejtim të saj 45 miliardë metër kub për një periudhë 15 vjeçare e cila kap një vlerë prej 10 miliardë dollarë. “Në vitin 2017, nisën eksportet e gazit natyror nga rezervuari Tamar në drejtim të Jordanisë në një masë prej 0.07 BCM, duke u rritur në 0.14 BCM në 2018 rreth 0.22 BCM në 2019 dhe rreth 0.23 BCM në 2020”⁷.

Këto dy fusha, por edhe shumë të tjera më të vogla që janë zbuluar, apo edhe që presin të zbulohen, do ta shndërrojë Izraelin në një nga vendet më të pasura me burime energjetike, e në të njëjtën kohë me eksportimin e gazit eksportohet edhe ndikimet politike dhe ekonomike që do t’i forcojnë asaj pozitën gjeopolitike, por janë disa impakte më të rëndësishme për Tel Avivin nga këto burime gjigande.

E para ka të bëjë me aspektin gjeopolitik, ku Izraeli me sasinë e madhe të gazit që ka zbuluar dhe me projektet për ta eksportuar të njëjtën, po e shndërron atë në një fuqi energjetike me përmasa globale, e në këtë situatë, fuqia dhe ndikimi i saj në rajonin e Mesdheut Lindor, Lindjen e Mesme, por edhe në politikën globale do të rritet edhe më shumë, e cila është shumë e rëndësishme për të, duke marrë parasysh të kaluarën konfliktuoze që ajo ka pasur me fqinjët e saj arab. Aktualiteti na tregon se shtetet që kanë burime të mëdha energjetike dhe e eksportojnë të njëjtën kanë një lloj “imunizimi” nga çdo destabilizim i brendshëm apo sulm i jashtëm, pasi në rast se një gjë e tillë ndodhë, atëherë

⁷ Tamar Petroleum Ltd, Annual Report 2020, f. 10, https://www.tamarpetroleum.co.il/wp-content/uploads/2021/06/Annual_Report_2020.pdf (26.06.2022)

rrizkohet tronditja e tregjeve ndërkombëtare energjetike e për pasojë edhe e ekonomisë globale, gjë që shtetet e fuqishme të botës nuk e tolerojnë, pasi pasojat e saj do të ishin katastrofike dhe në këtë mënyrë Tel Avivi do ta rrisë sigurinë e saj, përmes eksportit të energjisë.

“Këto zbulime kanë transformuar sigurinë e Izraelit pasi vendi më parë i varfër me energji tani mund të mbështetet në burimet e veta të gazit kur furnizimet nuk janë të disponueshme ose kur marrëdhëniet e tij me shtetet rajonale të pasura me energji të Lindjes së Mesme janë të tensionuara”⁸. Zbulimi i resurseve të gazit apo edhe të naftës ka bërë që të ndryshojnë raportet energjetike në rajon, ku Izraeli që nga mëvetësimi ka qenë i varur nga nafta dhe gazi i vendeve fqinje, ndërsa tani po shndërrohet në eksportues të saj në drejtim të shteteve, që dikur i shisnin saj. Kjo situatë e krijuar do të ndikojë që vendet fqinje të jenë të varura nga energjia izraelite, e kjo do të bëjë që ata të jenë më të kujdesshëm në qasjen dhe politikat që do të hartojnë në drejtim të saj, pasi çdo ndërprerje e gazit do të shkaktoje tronditje ekonomik dhe politike në ato shtete.

Një ndikim tjetër që do të kenë zbulimi i fushave të gazit për Izraelin lidhet me aspektin ekonomik, pasi shitja e saj do të gjenerojë miliarda dollarë të ardhura për buxhetin e shtetit, e kjo do të ndikojë në një zhvillim më të madh ekonomik, rritje të investimeve por edhe rritje të Bruto Prodhimit Vendor (GDP). Në vitin 2010, Izraeli prodhoi 40% të energjisë elektrike nga gazi i zbuluar në territoret e saj, duke i kursyer 1.4 miliardë dollarë, që tregon për impaktin e jashtëzakonshëm ekonomik që ka ky burim energjetik për të. Zbulimet e deritanishme të sasisë së gazit në këto fusha llogaritet të arrijnë një vlerë deri në 200 miliardë dollarë, por që kjo shifër mund të ndryshojë në rast se zbulohen fusha të tjera apo ulen gjetjet në krahasim me parashikimet.

“Deri më tani, zbulimi më i dukshëm i gazit natyror në ujërat qipriote ishte fusha e Afërditës në Bllokun 12 të bërë nga Noble Energy në vitin 2011, e vlerësuar të përmbajë 7 Tcf gaz natyror”⁹. Fusha e gazit Afërdita (Aphrodite) ende nuk ka filluar prodhimi i gazit, por që sipas autoriteteve qipriote, prodhimi nga kjo mund të fillojë mes viteve 2023-2025, që do ta shndërrojë ishullin në një eksportues të fuqishëm dhe më peshë në tregun e burimeve energjetike. Qiproja ka 13 zona ekonomike

⁸ Grigas, Agnia. *The New Geopolitics of Natural Gas*, Harvard University Press, USA 2017, f. 191.

⁹ Overview of oil and natural gas in the Eastern Mediterranean region, U.S. Energy Information Administration (EIA), 2013 (5.07.2022), https://www.eia.gov/international/content/analysis/regions_of_interest/Eastern_Mediterranean/eastern-mediterranean.pdf

ekskluzive, që nënkupton se ajo mund të përmbajë shumë më shumë rezerva të gazit, e këtë ë dëshmojnë edhe zbulimet e fundit që janë bërë edhe në bllokun 6 në fushën e Calypso në vitin 2018 dhe në bllokun 10 në fushën e Glaucus në 2019 u zbulua gaz natyror që vlerësohet se mban nga 5 deri në 8 trilion metër kub gaz dhe llogaritet në një vlerë të rreth 50 miliardë dollarëve, ndërsa këtë vit u raportua për zbulimin e një rezerve tjetër shumë të madhe në bllokun 6 në fushën Cronos-1 që llogaritet e para tregojnë se ajo mban një sasi prej rreth 78 miliardë metër kub gaz natyror. “Zbulimi i rezervave të gazit në Qipro tashmë po riformon hartën energjetike të rajonit, një çështje që ka efekte të jashtëzakonshme në politikën e rajonit”¹⁰. Sipas hulumtimeve theksohet se në Zonat Ekonomike Ekskluzive të Qipros ka rreth 2 miliardë fuçi naftë dhe rreth 31 trilionë metra kub gaz.

Zbulimi i rezervave të gazit natyror në Qipro, por edhe shumë të tjera që priten të zbulohen në të ardhmen, u bë në një moment shumë të nevojshëm për ishullin, ku situata e re krijoi një realitet të ri politik, ekonomik dhe energjetik, e cila do të ndryshojë balancat në rajon, do të ndryshojë qasjen që kanë fuqitë e mëdha ndaj këtij shteti, e këto rrethana do t’i japin asaj një pozitë të veçantë që do të jenë shumë pozitive për Nikozinë.

E para ka të bëjë më forcimin e pozitave gjeopolitike të Qipros në rajonin e Mesdheut Lindor, por edhe në përgjithësi në marrëdhëniet ndërkombëtare, pasi zbulimi i burimeve të mëdha të gazit e bëjë atë një aktor të rëndësishëm në tregun ndërkombëtar energjetik, kjo i mundëson asaj përfitimin e mbështetjes politike të aktorëve global që është shumë e nevojshme për të duke marrë parasysh fatin se ishulli për më shumë se 38 vite është i ndarë në dy pjesë, dhe në të njëjtën kohë ajo ka konteste të pa zgjidhura me fqinjin e saj Turqinë, e situata e re, do t’i jep ishullit një pozitë më të barabartë në tryezën e negociatave për të arritur një zgjidhje që është në dobi të saj.

Qiproja ndonëse është afër Lindjes së Mesme, ajo ka qenë tejet e varfër sa i përket burimeve energjetike, që nënkupton se ishulli ka qenë tërësisht i varur nga importi për të mbuluar nevojat e brendshme. “Qiproja importon rreth 2.5 milionë MT në vit (2018) produkte të naftës të rafinuar, ndërsa shumica e tyre importohen nga vendet fqinje, p.sh.

¹⁰ Trimikliniotis, Nicos, Bozkurt, Umut. Beyond a Divided Cyprus: A State and Society in Transformation, Palgrave Macmillan, UK 2012, f. 26.

Greçia dhe Izraeli”¹¹. Me situatën e re të krijuar, ajo do të minimizojë importet, pasi tani energjinë do të prodhojë nga burimet e veta, që nënkupton se ajo nuk do të jetë më e varur nga burimet e huaja, e kjo do t’i mundësojë përfitim të madh financiar, por edhe “imunizim” ndaj ndikimeve politike që kanë ardhur bashkë me varësinë energjetike.

Efekt i tjetër pozitiv që do të përjetojë Qiproja nga situata e krijuar, ka të bëjë me aspektin ekonomik, ku ajo do të përfitojë shumë nga ulja e importeve që ka bërë më herët, dhe në të njëjtën kohë do të rrisë eksportet e gazit që do t’i sjellin asaj miliarda dollarë që janë aq shumë të nevojshme, pasi ishulli ende nuk e ka marrë veten nga goditja e krizës ekonomike të vitit 2008, gjithashtu kjo do të rrisë investimet, punësimet dhe do të ndikojë direkt në rritjen e Bruto Prodhimit Vendor, e kjo do të bëjë që kriza financiare mund të jetë vetëm një kujtim i hidhur. Sasia e gazit natyror të zbuluar ka disa impakte shumë të fuqishme: Vlera monetare paraprake që llogaritet e gazit të zbuluar deri më tani shkon në rreth 129 miliardë dollarë dhe në të njëjtën kohë, sasia e zbuluar e saj, mund të sigurojë energji elektrike për ishullin për 210 vjet.

Zbulimet e mëdha që u arritën në Qipro dhe Izrael bënë që hulumtimet të fokusoheshin dhe të zgjeroheshin në të gjithë hapësirat e Mesdheut Lindor, pasi besohej se ekzistojnë edhe shumë shtresa apo fusha të tjera gazë mbajtëse, por që të cilët ende nuk ishin të eksploruar, e si një ndër to përmendej edhe Pellgu i Deltës së Nilit në të cilin besohej se gjendeshin rreth 6.4 miliardë metër kub gaz të pa zbuluar dhe 1.8 miliardë fuçi naftë.

“Pellgu i Deltës së Nilit shtrihet në një zonë të madhe gjeografike (afërsisht 120000 km²) e vendosur në pjesën verilindore të Egjiptit, në veriperëndim të Gadishullit Sinai”¹². Këto parashikime se ky pellg ka rezerva të mëdha doli i vërtetë, pasi në vitin 2015 u zbuluan sasi shumë të mëdha të gazit në fushën e Zohrit, e cila gjendet rreth 190 kilometra larg Port Said, e që shtrihet brenda bllokut Shorouk me një sipërfaqe prej 100 kilometra katrorë, e rezervat e së cilës vlerësohen deri në 30 trilionë metër kub gaz, e në rast se këto shifra vërtetohen, atëherë ajo do të dyfishonte rezervat e kapaciteti i saj prodhues është 3.2 miliardë

¹¹ Report: Cyprus’ Integrated national energy and climate plan for the period 2021-2030, Cyprus 2020, f.83, https://ec.europa.eu/energy/sites/ener/files/documents/cy_final_necp_main_en.pdf (12.07.2022)

¹² Med. Sea, Nile Delta & North Sinai Sedimentary Basins, https://www.petroileum.gov.eg/ar-eg/investment/technical-services/georeportslist/Offshore_Mediterranean%20_Geology_Overview.pdf (13.07.2022)

metër kub në dit, e që vlera monetare e kësaj sasive të gazit llogaritet në mbi 100 miliardë dollarë amerikanë. “Aktualisht, Egjipti dhe Izraeli janë dy vendet më të rëndësishme në Mesdheun Lindor për sa i përket madhësisë së rezervave të provuara, prodhimit dhe konsumit të gazit.”¹³ Egjipti vlerësohet se ka një rezervë prej 63 trilionë metër kub, por prodhimi i gazit ka qenë i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat e brendshme, e kjo e ka detyruar atë që të kërkojë alternativa për t’u furnizuar me gaz, kjo ka bërë që ajo të jetë e varur nga shtetet tjera, por që zbulimet e reja do ta shpëtojnë atë nga varësi dhe në të njëjtën kohë do ta bëjnë një aktor me peshë në tregun energjetik rajonal dhe ndërkombëtar, me efekte të fuqishme gjeopolitike dhe ekonomike.

Turqia përmes Korporatës Shtetërore Turke të Naftës (TPAO) ka filluar kërkimet për zbulimin e rezervave të gazit natyror, por që deri më tani nuk ka arritur të bëjë ndonjë zbulim domethënës, por që në të njëjtën kohë kërkimi i saj ka shkaktuar reagime dhe tensione në rajon, e gjithë kjo ka bërë që të rrezikohet paqja dhe siguria në të gjithë Mesdheun Lindor. Situata është tensionuar pasi Ankaraja ka kryer hulumtime për hidrokarbure rreth Qipros në emër të Republikës Turke të Qipros Veriore, e cila shkaktoi reagime të ashpra të Nikozisë, por që edhe përkundër kësaj, kërkimet nuk janë ndalur.

Libani ndonëse ka bërë kërkime në të kaluarën nuk ka arritur që të zbulojë rezerva, por që hulumtimet e fundit tregojnë se në ujërat e saj territoriale ka rezerva të mëdha të gazit natyror që shkojnë deri në 750 BCM, si dhe mendohet se ka nga 460 deri në 750 milionë fuçi naftë, por që kërkimet për të po e pamundësojnë dy gjëra: E para ka të bëjë me kontestin e ujërave kufitare me Izraelin, ku këto dy shtete edhe nuk kanë një marrëveshje demilitarizimi dhe ndarje të Zonave Ekonomike Ekskluzive, e që jo vetëm që po pengon kërkimet, por është edhe një kërcënim potencial për paqen dhe sigurinë në Mesdheun Lindor. “Libani nuk e njohu marrëveshjen dypalëshe të nënshkruar ndërmjet Izraeli dhe Qipro, sepse nuk u pajtua me trekëndëshin e barabartë të Qipros, Izraelit dhe Libanit, i cili kapërceu pothuajse 850 kilometra katrorë të Zonës Ekonomike Ekskluzive të Libanit”¹⁴. E dyta ka të bëjë

¹³ Boustros, Elias. Natural Gas in East-Mediterranean Basin – Changing the Energy Landscape, Qatar 2018, f. 6 (15.07.2022)

¹⁴ Hamadeh, Khaled. Development of the Middle East Gas: Opportunities & Challenges, Konrad Adenauer Stiftung, Lebanon 2019, f.14, <https://www.kas.de/documents/284382/284431/Policy+paper+19-05-25+Khaled+Hamadeh+Oil+and+Gas+-+EN.pdf/a9a3c044-9f26-c8c7-99c1-655dc3c4c4b3?version=1.0&t=1573833297645> (17.07.2022)

me paqëndrueshmërinë e brendshme politike, dhe përplasje sektare që karakterizojnë këtë vend, e cila po penalizon krijimin e një strategjie për kërkimin e burimeve energjetike, dhe në të njëjtën kohë kjo po e pamundëson që ajo të përfitojë miliarda dollarë nga eksporti i saj, që janë shumë të nevojshme për një zhvillim ekonomik që do të mund ta kthente paqen e brendshme.

Siria nuk ka bërë kërkime në vitet e fundit për burime energjetike në zonat ekskluzive ekonomike të saj, edhe përkundër faktit se hulumtimet kanë treguar se nëntoka e saj përmban miliarda kubik gaz, si dhe naftë, por që lufta civile që po kalon ky vend për më shumë se 10 vjet, e ka penalizuar atë që të marrë miliarda dollarë që mund të gjenerohen nga eksporti i gazit, e në të njëjtën kohë do ta ulte varësin e saj nga importi dhe do të ndikonte në zhvillimin ekonomik që është shumë i nevojshëm për të. Rripi i Gazës dhe Bregu perëndimor, janë të varura plotësisht nga burimet energjetike, pasi ato nuk disponojnë as naftë apo edhe gaz natyror, që i detyron ata të eksportojnë prej Izraelit, dhe çdo vit ata i paguajnë Tel Avivit rreth 2 miliardë dollarë çdo vit për burimet energjetike. Autoritete Palestineze, pretendojnë se në bazë të Marrëveshjes së Oslo II, ata kanë juridiksion detare 20 milje (32.1 km) nga bregu, do t'i jepte qasje në fushën Leviathan, por që nga bllokada e vitit 2007, Izraeli ka vendos *de facto* kontroll mbi hapësirën detare të Gazës.

EastMed dhe Mesdheu Lindor

Mesdheu Lindor do të pasurohet edhe me një tubacion tjetër, i cili është në projektim e sipër, i njëjti ende nuk ka filluar që të ndërtohet, por që marrëveshja për realizimin e saj është nënshkruar, që nënkupton se shumë shpejt pritet edhe materializimi i saj. “Projekti i gazsjellësit EastMed synon të lidhë Izraelin dhe Qipron me Greqinë dhe Italinë”¹⁵. Ky tubacion pritet që të ketë një gjatësi prej 1900 kilometra, që pritet të jetë më i gjatë i gazit në botë që kalon përmes detit, e që e njëjta do të ketë një kapacitet prej 10 miliardë metër kub gaz në vit, ndërsa mendohet se kapaciteti maksimal i saj të arrijë në 20 miliardë metër kub gaz në vit, ndërtimi i saj do të fillojë në vitin 2022 dhe pritet që i njëjti të përfundojë në vitin 2025-2027, vlera e së cilës shkon në 6.9 miliardë dollarë.

¹⁵ Staniç, Ana, Karbusz Sohben, The Commercial Challenges Facing Eastern Mediterranean Gas, Journal of Energy & Natural Resources Law, Volume 39, 2021, f. 15
https://resourcegovernance.org/sites/default/files/documents/the_east_mediterranean_gas_for_um_regional_cooperation_amid_conflicting_interests_0.pdf (18.07.2022)

Impakti i parë gjeopolitik vërehet në përpjekjet që po bën Bashkimi Evropian për ndërtimin e këtij tubacioni, pasi në rast se ai do të realizohet, kjo do të jetë një fitore e madhe për Brukselin, pasi ajo përmes EstMed, jo vetëm që do t'i plotësojë kërkesat e saj në rritje për gaz natyror, por që përmes saj ajo do t'i devirsifikojë burimet e saj energjetike, e kjo do ta "shpëtojë" atë nga varësia që ka krijuar nga gazi rus.

Shtete e Bashkuara të Amerikës në fillim ishte një mbështetëse shumë e zjarrtë e këtij tubacioni, pasi përmes EstMed, ata po synojnë që ta rivalizojnë TurkishStream, që nënkupton të krijojë një burim alternativ për shtete e Bashkimit Evropian apo edhe vendeve tjera të rajonit nga gazi rus, por Uashingtoni u tërhoq nga mbështetja e kësaj iniciative, duke krijuar paqartësi rreth të ardhmes së këtij tubacioni.

Greçia dhe Qipro, do të kenë përfitime të mëdha gjeopolitike nga EstMed, pasi ata do të shndërrohen në një shtet nyjë (Hub Country) në rrjedhën e gazit natyror në drejtim të tregjeve të kontinentit të Evropës, e kjo do të bëjë që ata të kenë një ndikim të shtuar në politikën e BE-së.

Turqia ka kundërshtuar fuqishëm këtë tubacion, ku EstMed do të ndikojë negativisht në gjeopolitikën e saj si shtete nyjë (Hub Country), pasi ky projekt do ta shmang territorin e kësaj të fundit, që do të bëjë që ajo mos të ketë ndikim në rrjedhat e gazit natyror të Mesdheut Lindor në të Evropës.

Zbulimi i sasive të mëdha të gazit në Mesdheun Lindor, por edhe komplikimet dhe dilemat që sillte situata e re e krijuar, ndikuan që të krijohet një mekanizëm që do të koordinonte politikat energjetike të vendeve të rajonit, por edhe fuqive jashtë-rajonale, që kishin interesa gjeopolitike dhe energjetike në këtë hapësirë. "Mbi një dekadë pas zbulimeve të para të mëdha të gazit në pellgun e Levantit dhe një vit pas një takimi të parë në Kajro më 14 janar 2019, përfaqësuesit e Qipros, Egjiptit, Greqisë, Izraelit, Italisë, Jordanisë dhe Autoritetit Palestinez u takuan për herë të tretë në Kajro më 16 janar 2020 për të finalizuar kornizën për nisjen e Forumit të Gazit të Mesdheut Lindor (EMGF) si një organizatë ndërkombëtare ndërqeveritare me seli në Kajro"¹⁶. Ajo që bie në sy në këtë forum, ka të bëjë me faktin se ajo nuk përfshinë të gjithë vendet e Mesdheut Lindor, pasi në të mungonte Siria, e cila e ngërthyer në një luftë civile të përgjakshme që po vazhdon për më shumë se një dekadë, Libani e cila

¹⁶ Sukkariéh, Mona. The East Mediterranean Gas Forum: Regional Cooperation Amid Conflicting Interests, Natural Resource Governance Institute, USA, 2021, f. 2
https://resourcegovernance.org/sites/default/files/documents/the_east_mediterranean_gas_forum_regional_cooperation_amid_conflicting_interests_0.pdf (19.07.2022)

nuk pranoi që t'i bashkëngjitet asaj si pasojë e kontestit kufitar që kishte me Izraelin, Libia po ashtu nuk kishte një ftesë për anëtarësim, ndërsa Turqia ishte lënë qëllimisht jashtë saj.

Conclusion

The discovery of natural gas reserves in the Eastern Mediterranean marked an extraordinary shift in energy geopolitics, after a region poor in energy resources, it will turn into an important factor in the global energy market and will give the region a greater position and influence. major in international relations. Israel, as one of the poorest countries with energy resources, after new discoveries will turn into its exporter towards neighboring countries, but even wider ones. This has given Tel Aviv a very great geopolitical importance, since through gas it will increase its influencing power in regional and international politics, and at the same time it will increase its security.

Cyprus is another Eastern Mediterranean country that has been almost totally dependent on foreign energy sources, but the situation changed in 2011, when the Aphrodite field was discovered, which contained a very large amount of natural gas. This was a blessing for Nicosia, as the newly created situation has given great political and economic benefits. In the political aspect, gas has given Cyprus the greatest weight in the Eastern Mediterranean, but also in global politics, which it did not have before. In the economic aspect, Nicosia has benefited a lot, after being a country dependent on energy resources, now it is not only meeting its needs, but also in positions and becoming its exporter, which would bring extraordinary income. its budget. Egypt has also benefited from the underground of the Eastern Mediterranean, after the discovery of the Zohr field, which will affect the relief of Cairo's dependence on the import of hydrocarbons, which would be an extraordinary economic and political benefit for it.

EstMed caused positive and negative reactions, as it affects the interests of many countries and has an impact beyond the region. The European Union has strongly supported this project as it allows Brussels to reduce its dependence on Russian gas. The US was another big supporter of the project, but Washington has recently backed away from its previous stance on the project. Turkey had strongly opposed the project, as it endangered its position as a hub country for transporting hydrocarbons to the continent. The future of this project continues to

remain unclear. The gas forum, which was created by Eastern Mediterranean states but also extra-regional states, is expected to have an impact on the coordination of energy policies, but it should not be hoped that it will have a strong impact considering that ours does not unite all states of the region.

Recensentë:

Prof. Dr. Nazmi Maliqi

Prof. Dr. Zineta Hasani

Bibliografia:

Boustros, Elias. Natural Gas in East-Mediterranean Basin – Changing the Energy Landscape, Qatar 2018, <https://www.researchgate.net/publication/329453610>

C.J. Schenk, Assessment of Undiscovered Oil and Gas Resources of the Levant Basin Province, Eastern Mediterranean, <https://pubs.usgs.gov/fs/2010/3014/pdf/FS10-3014.pdf>

Grigas, Agnia. The New Geopolitics of Natural Gas, Harvard University Press, USA 2017

Med. Sea, Nile Delta & North Sinai Sedimentary Basins, https://www.petroleum.gov.eg/ar-eg/investment/technicalservices/georeportslist/Offshore_Mediterranean%20_Geology_Overvie.pdf

Report: Cyprus' Integrated national energy and climate plan for the period 2021-2030, Cyprus 2020, https://ec.europa.eu/energy/sites/ener/files/documents/cy_final_necp_main_en.pdf

Staniç, Ana, Karbuz Sohben, The Commercial Challenges Facing Eastern Mediterranean Gas, Journal of Energy & Natural Resources Law, Volume 39, 2021 https://resourcegovernance.org/sites/default/files/documents/the_east_mediterranean_gas_forum_regional_cooperation_amid_conflicting_interests_0.pdf

Sukkarieh, Mona. The East Mediterranean Gas Forum: Regional Cooperation Amid Conflicting Interests, Natural Resource Governance Institute, USA, 2021, https://resourcegovernance.org/sites/default/files/documents/the_east_mediterranean_gas_forum_regional_cooperation_amid_conflicting_interests_0.pdf

Tamar Petroleum Ltd, Annual Report 2020, f. 10, https://www.tamarpetroleum.co.il/wp-content/uploads/2021/06/Annual_Report_2020.pdf

Trimikliniotis, Nicos, Bozkurt, Umut. Beyond a Divided Cyprus: A State and Society in Transformation, Palgrave Macmillan, UK 2012

Victor Kattan, "The Gas Fields off Gaza: A Gift or a Curse?" Al Shabaka, the Palestinian Policy Networ,https://al-shabaka.org/wp-content/uploads/2012/04/Kattan_PolicyBrief_Eng_April_2012.pdf

Zemach, Shaul. Toward an Eastern Mediterranean Integrated Gas Infrastructure?, The German Marshall Found of the United States, USA 2016, https://www.gmfus.org/sites/default/files/Zemach_EmedIntegratedGasInfrastructure_Apr16_web.pdf

Mediterranean, U.S. Geological Survey, March 12, 2010, <https://pubs.usgs.gov/fs/2010/3014/pdf/FS10-3014.pdf>

Nathanson, Roby, Levy, Ro'ee. Natural Gas in the Eastern Mediterranean Casus Belli or Chance for Regional Cooperation?, Israel 2012, <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/israel/09591.pdf>

Overview of oil and natural gas in the Eastern Mediterranean region, U.S. Energy Information Administration (EIA), 2013, https://www.eia.gov/international/content/analysis/regions_of_interest/Eastern_Mediterranean/eastern-mediterranean.pdf